Arrestohen disa persona nga aksioni i Antidrogës, sekuestrohet armë dhe drogë

26/01/2023 17:10

Policia e Kosovës ka realizuar disa operacione gjatë 24 orëve të fundit me qëllim të parandalimit dhe luftimin e abuzimit me substanca narkotike.

Në këtë kontekst, më 25 janar të këtij viti, hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotik në Gjilan, pas pranimit të informacioneve se disa persona të dyshuar kanë në posedim sasi të substancës narkotike të llojit "marihuanë", kanë ndërmarrë veprime taktike-operacionale për kapjen e personave të dyshuar të cilët dyshohej se bëniin të mundur shpërndarjen dhe shitjen e narkotikëve në disa lagje të Komunës së Gjilanit.

"Pas lokalizimit të vendndodhjes së personave të dyshuar, janë realizuar veprime të shpejta operacionale dhe njësitë policore kanë arrestuar tre personat e dyshuar meshkuj/kosovar. Si prova materiale nga të dyshuarit gjatë operacionit të kontrollit është konfiskuar sasi e substancës narkotike (373.1 gr dhe 822.6 gr) dhe një peshore digjitale", thuhet në njoftimin e policisë.

Po ashtu, në mbrëmjen e djeshme, më 25 janar, në rajonin e Prishtinës hetuesit e antidrogës gjatë një operacioni kanë arrestuar dy persona të dyshuar të tjerë për posedim droge dhe kanë kryer bastisje në lokacionet e tyre.

Dëshmitë relevante janë sekuestruar nga policia për procedura të mëtejme ligjore.

Antidroga ka kryer edhe një operacion tjetër i cili është realizuar sot më 26 janar në rajonin e Pejës, ku me urdhër të organeve të drejtësisë, në mbështetje të Njësive për reagim të shpejtë – NJRSH, Pejë, është zbatuar urdhër kontroll në lokacionin e dy personave të dyshuar dhe gjatë operacionit të bastisjes-kontrollit të shtëpisë, tek njëri i dyshuar janë gjetur: Një revole, një grinder (mulli për bluarje të marihuanës) dhe substancë e dyshuar narkotike e llojit "Marihuanë" në peshë prej 119.4 gram e cila ishte e ndarë në vende të ndryshme.

"Në vazhdën e bastisjes-kontrollit, në dhomën e të dyshuarës tjetër në një kasafortë metali janë gjetur dhe sekuestruar 5.8 gram substancë e dyshuar narkotike e llojit Marihuanë", thuhet në njoftimin e policisë.

Policia ka bërë të ditur se të gjitha veprimet policore janë ndërmarr në bashkëpunim me prokurorinë kompetente për procedura të mëtejme ligjore. **/Lajmi.net/**



LAJME TË FUNDIT

SHBA-ja e shpall organizatë kriminale grupin "Wagner"

Të rinjtë e AAK-së me video i kundërpërgjigjen...

Kiara kërkon hapësirë, Luizi: Unë nëse largohem, nuk kthehem më

Formacionet zyrtare: Real Madrid – Atletico Madrid

Artikuj të ngjashëm

January 26, 2023
SHBA-ja e shpall organizatë kriminale grupin "Wagner"

January 26, 2023
Të rinjtë e AAK-së me video i kundërpërgjigjen VV-së, ia listojnë...

January 26, 2023
Molliqaj përkrah aksionin e PDK-së: Martin Berishaj nuk përfaqëson Kosovën por...

January 26, 2023
Osmani takon ambasadorin amerikan, zbulon çfarë diskutuan

January 26, 2023
Rohde: Nuk ka garanci se në fund të dialogut Kosovën e...

January 26, 2023
Shpërthimi i zjarrit në Kazermën e Istogut, japin detaje nga ministria

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy

-Advertisenent-